



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

**Prishtinë, më 26 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1905/21**

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI155/20

Parashtrues

Rasim Sopa

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit,
Ac.nr.2000/2015, të 31 marsit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Rasim Sopa (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2000/2015, të 31 marsit 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 7 gusht 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar i cili, sipas pretendimeve të tij, ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza Juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, ka kërkuar që të mos i publikohet identiteti.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 3 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 12 tetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 11 nëntor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
10. Më 11 nëntor 2020, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren që t'i dorëzonte asaj fletëkthesën, në mënyrë që Gjykata të mund të përcaktonte datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar [Ac.nr.2000/2015] të Gjykatës së Apelit.
11. Më 24 nëntor 2020, Gjykata Themelore në Prizren i dorëzoi Gjykatës dëshminë e dorëzimit të Aktgjykimit [Ac.nr.2000/2015] të Gjykatës së Apelit, që mbante datën e dorëzimit 7 gusht 2020.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullin 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u

zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës Nr. KK-SP 71-2/21, u konfirmua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani do të merrte pozitën e Kryetares së Gjykatës pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me vendimin nr. Nr.K.SH.KI 155/21, përcaktoi që gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
15. Më 26 qershor 2021, në bazë të paragrafit (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa në bazë të pikës 1.1, paragrafi 1, të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi e përfundoi mandatin e Kryetares dhe gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 3 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Në një datë të pacaktuar në vitin 1994, parashtruesi i kërkesës parashtroi një kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prizren për përcaktimin e pronësisë mbi objektin e banimit në pronësi të M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K., trashëgimtarë të të ndjerit M.K. Me këtë kërkesë, parashtruesi i kërkesës kërkoi që gjykata të konfirmojë pronësinë e tij mbi pronën kontestuese, sepse ai, në bazë të një marrëveshjeje gojore me të ndjerin M.K. pati një marrëveshje që të ndërtojë me fondet e tij një shtëpi në ngastrën e ndarë M.K.-së, të cilën M.K. më vonë do t'ia jepte atij.
18. Më 25 shkurt 1997, Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktgjykimit [P.nr. 173/94], e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe i obligoi të paditurit M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K. që t'ia dorëzojnë pronën e kontestuar në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës dhe t'i mundësojnë parashtruesit të kërkesës që të transferojë të drejtat e pronësisë.
19. Në një datë të pacaktuar në vitin 1997, të paditurit M.K., A.K., R.K., A.K., M.K., dhe H.K. parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit [P.nr. 173/94] të Gjykatës Komunale në Prizren, për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
20. Më 21 nëntor 1997, Gjykata e Qarkut, me Aktvendimin [Gzh.nr. 694/97], e miratoi ankesën e të paditurve M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K. dhe e

anuloi Aktgjykimin [P.nr. 173/94] të Gjykatës Komunale në Prizren të 25 shkurtit 1997 si dhe ia ktheu çështjen gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

21. Më 19 shkurt 1998, Gjykata Komunale në Prizren në procedurën e përsëritur, përmes Aktgjykimit [P.nr. 927/97], përsëri e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe i obligoi të paditurit M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K. që pronën e kontestuar t'ia dorëzojnë në shfrytëzim parashtruesit të kërkesës dhe t'i mundësojnë parashtruesit të kërkesës që të transferojë të drejtat e pronësisë.
22. Në një datë të pacaktuar, të paditurit M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K. parashtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit [P.nr. 927/97] të Gjykatës Komunale në Prizren, për shkak të: *“shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
23. Më 31 gusht 2000, Gjykata e Qarkut, përmes Aktvendimit [Ac.nr. 28/2000], e miratoi ankesën e të paditurve M.K., A.K., R.K., A.K., M.K. dhe H.K. duke e anuluar Aktgjykimin [P.nr. 927/97] të Gjykatës Komunale në Prizren të 19 shkurtit 1998 dhe ia ktheu rastin gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.
24. Më 10 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Prizren në rigjykim me aktgjykim [C. nr. 201/2000] refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e pronësisë mbi pronën e patundshme me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se mes tij dhe të ndjerit M.K. ka ekzistuar çfarëdo qoftë marrëveshje , as me shkrim as me gojë, gjithashtu gjykata deklaroi se ndërtimi i objektit të dikujt tjetër nuk mund të siguronte të drejtën pronësore për të cilën aspiron kërkuesi. Së fundi, tokën ndërtimore e ka fituar i ndjeri M.K., madje edhe nëse ka pasur një marrëveshje ndërmjet të ndjerit M.K. dhe parashtruesit të kërkesës, kjo marrëveshje nuk mund të zëvendësojë vendimet e organit administrativ për kalimin e të drejtave dhe shfrytëzimin e tokës ndërtimore dhe marrjen e lejes së ndërtimit, sepse këto mundësi parashihen vetëm me norma të veçanta ligjore dhe janë të natyrës imperative.
25. Në një datë të pacaktuar në vitin 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C.nr.201/2000] të Gjykatës Themelore në Prizren, për shkak *“shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
26. Më 31 mars 2020, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [Ac.nr.2000/2015], e refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi në tërësi Aktgjykimin [C.nr.201/2000] e Gjykatës Themelore të 10 dhjetorit 2014,

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore i shkelën të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24

[Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: „Shkeljet janë ardhur si rezultat i shkeljeve ligjore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe mos marrjes parasysh të provave të prezantuara nga ne, pasi neve na është njohur e drejta jonë si pronar me vendimet e mëhershme, por që të njëjtat janë prishur dhe në rivendosje nuk janë administruar si duhet provat kyçe, sikurse janë pagesat tona për atë pronë si dhe deklaratat e paraardhësit të të paditurve, ku pranon pronësinë tonë lidhur me pronën kontestuese. Pra kemi mohim të së drejtës sonë për pronësinë, mohim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm dhe me këto veprime të gjykatave kemi shkelje të dispozitave kushtetuese, të cekura më lartë nga ne”.
29. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën që kërkesa e tij të miratohet dhe lënda të kthehet për rivendosje, duke deklaruar që: “të na njihet e drejta jonë si pronar i paluajtshmërisë kontestuese, sikurse ka vendosur edhe gjykata në aktgjykimin e parë, duke na aprovuar kërkesëpadinë dhe duke vërtetuar pronësinë tonë mbi paluajtshmërinë kontestuese, pasi ne kemi kontribuar dhe kemi investuar në blerje duke pasur parasysh edhe deklaratën e vet parashtruesit të kërkesës, ku ceket se kjo pronë është e paditësit Rasim Sopaj, por vetëm se kërkesa është bërë nga Murat Krasniqi si dajë i paditësit, pasi ka pasur pengesa administrative që vet të parashtron kërkesën, por pagesat, investimet dhe të gjitha obligimet janë kryer nga paditësi, këtu parashtruesi i ankesës”.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që mos ta bëjë publik identitetin e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

33. Për më tepër, Gjykata i referohet gjithashtu edhe kriterëve të pranueshmërisë, siç janë paraparë me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47

[Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, përmes së cilës e konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Ac. nr.2000/2015] të Gjykatës së Apelit të datës 31 mars 2020, pasi që ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka theksuar të drejtat dhe liritë për të cilat ai pretendon se i janë shkelur, në përputhje me kushtet e nenit 48 të Ligjit si dhe e ka parashtruar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

35. Për më tepër, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës e ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë të paraparë në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

36. Gjykata së pari vëren se rregulli i mësipërm, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës, mundëson që kjo e fundit t'i deklarojë të papranueshme kërkesat, bazuar në arsyet që lidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, mbi bazën e këtij rregulli, Gjykata mund ta deklarojë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pasi të ketë vlerësuar meritat e saj, përkatësisht nëse konstaton se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza

kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkalles së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i); *Mentzen kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii); dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).
38. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
39. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e kontestuara kanë shkelur nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.
40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit të njëjtat argumente të cilat ai i kishte parashtrua në procedurat para Gjykatës Themelore dhe të Apelit, se gjykatat e rregullta janë marrë me këtë çështje, kështu që Gjykata do t’i shtjellojë më tej procedurat para gjykatave të rregullta në paragrafët në vijim.

(i) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

41. Në këtë kontekst, Gjykata para se gjithash rikujton se rrethanat e çështjes lidhen me kërkesën e parashtruesit të kërkesës që ishte parashtruar në gjykatat e rregullta dhe me qëllim që të përcaktohet pronësia mbi pronën e paluajtshme të kontestuar, dhe pas disa procedurave dhe gjykimeve të përsëritura, së pari Gjykata Themelore e refuzoi kërkesën e parashtruesit, e më pas Gjykata e Apelit e vërtetoi në tërësi vendimin e shkallës së parë. Gjykatat e rregullta arritën në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk përmbushte asnjë nga kushtet ligjore për realizimin e të drejtës pronësore mbi pronën e paluajtshme të kontestuar.
42. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës përmbledhen në *vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit*, më çfarë ai

ngre çështjen e aplikimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, që bie ekskluzivisht brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (ligjshmëria).

43. Me rastin e shqyrtimit të këtyre pretendimeve, Gjykata së pari thekson se ato në thelb kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, pretendime të cilat Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si *“pretendime të shkallës së katërt”*.
44. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. "Shkalla e katërt", paragrafët 281 dhe 288), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të *“kushtetutshmërisë”* dhe *“ligjshmërisë”* dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetut dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, me parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, me parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SHA., "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; si dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues *Basri Deva, Afordita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
45. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe aplikimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e *“shkallës së katërt”*, e që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kunder Spanjes*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; shih, gjithashtu, edhe rastet e Gjykatës, KI49/19, të cituar në tekstin me lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, të cituar me lart, paragrafi 61).
46. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç është thënë më lartë, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurojë apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, të cituar në tekstin më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat

rezultojnë të jenë qartazi arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykate ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (për një shpjegim më të hollësishëm të konceptit të “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti i të drejtave civile), të 31 gushtit 2020, Pjesa IV. Kriteret procedurale; 3. Shkalla e Katërt, b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes të cilën e bën GJEDNJ, paragrafët 329-333, dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, të cituar në tekstin më lart, paragrafët 60 deri 65 dhe referencat e përdorura aty).

47. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, Gjykata thekson se “drejtësia” që kërkohet përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet përmes procedurës kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (shih rastin e Gjykatës KI131/19, me parashtrues *Sylë Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 prillit 2020, paragrafi 57; dhe rastin KI49/19, të cituar në tekstin më lart, paragrafi 55).
48. Kjo me saktësisht nënkupton, në kuptimin praktik, termi “*drejtësi procedurale*” do të thotë: (i) mundësia e procedurës kontradiktore/parimi i procedurës kontradiktore; (ii) mundësinë që palët në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe prova që ata i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efektiv të argumenteve dhe provave të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre, të cilat objektivisht konsiderohen të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, të dëgjohen dhe të shqyrtohen siç duhet nga gjykatat e rregullta (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, aktgjykimi i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68, dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese KI128/19, të cituar më lart, paragrafi 58, dhe KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendimi për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
49. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ndërliken me interpretimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta. Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se deri te *shkeljet ka ardhur si rezultat i shkeljeve ligjore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe për shkak të mos-marrjes parasysh të dëshmive të cilat janë prezantuar nga ana e jonë*.
50. Për me tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregulla i kishin shqyrtuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, që ndërliken me dispozitat ligjore, vërtetimin e gjendjes faktike dhe paraqitjen e dëshmive.
51. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [C. nr. 201/2000] të 10 dhjetorit 2014, deklaroi me sa vijon:

“Fakt se ai me kryerjet në ndërtim të objektit ka ndërmarrë shumë punë në objekt, por ai i ka ndërmarrë pa pëlqimin, i cili duhet me qenë me karakter kategorik, me të cilin padyshim të shprehet vullneti se objekti i cili ndërtohet

të behet edhe pronë e paditësit , prandaj, i njëjti nuk mund të fitoj në të të drejtën e pronës, por vetëm kërkesën eventuale të asaj që ka investuar në emër të ndërtimit në mungese të marrëveshjes se ndergjyqësve. Do të kishte vend të dukjes në pah të kërkesës të së drejtës pronësore atëherë kur do të ekzistonte marrëveshja dhe e njëjta të realizohej në tërësi ku në këtë rast ndërtuesi i përgjegjshëm do të fitonte të drejtën e pronës, duke pas parasysh dispozitat e nenit 24. alinea 1 të Ligjit mbi bazat e marrëdhënieve pronësore-juridike (2). Aplikimi i këtyre normave ligjore ka vend kur pronari i tokës ka ditur për ndërtimin dhe menjëherë nuk ka kundërshtuar, që këtu nuk është rasti, sepse në rastin konkret pronari i tokës ndërtimore të komunave në kuptim të nenit 3 të Ligjit mbi token ndërtimore të komunave (3) siguron shfrytëzim racional të tokës ndërtimore në harmoni me parimet e përcaktuara me ligj, kurse me nenin 10. alinea 1. të të njëjtit ligj është parapare që komuna të drejtoj dhe disponon me tokën e ndërtimit te qytetit.”

52. Duke shqyrtuar pretendimet e njëjta, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 2000/15] të 31 marsit 2020, paraqiti arsyet për refuzimin e ankesës, duke deklaruar si vijon:

“Nga provat e administruara nuk është vërtetuar pretendimi se paditësi ka pasur marrëveshje me të ndjerin Murat Krasniqi, që ky aplikimin për ndarjen e pllacit për ndërtimin e shtëpisë e ka bere për paditësin, për këtë nuk ka marrëveshje të shkruar, por paditësi ka dështuar të vërtetoj se për këtë ka pasur edhe një marrëveshje gojore. Asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk ka deklaruar se ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejt i kësaj ngjarje, se ka qenë prezent kur kjo marrëveshje është arritur në mes paditësit dhe të ndjerit Murat, apo edhe se është folur për këtë marrëveshje në mes tyre në prani të personit të trete, andaj bazuar në nenin 319.1 lidhur me nenin 322.1 të LPK-se, ku parashihet që secila palë ndergjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon pretendimet e veta, ku dhe barra e provës në këtë çështje i bie paditësit, dhe deri sa nuk ka provuar faktin thelbësor në këtë çështje se ka qenë me mire besim në raport me të ndjerin Murat Krasniqi dhe trashëgimtarët e tij, kërkesëpadia nuk mund të aprohet.”

53. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, në rrethanat e rastit konkret, kanë shqyrtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, dhe Gjykata gjithashtu vëren se gjykatat e rregullta kanë konstatuar se nuk ka ekzistuar asnjë akt juridik përkatësisht veprim në bazë të cilit paditësi ka mundur të arrijë marrëveshje me të ndjerin në lidhje me lëndën sipas kërkesëpadisë. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të realizojë të drejtat pronësore në bazë të ndërtimit të një objekti familjar banimi, sepse për të fituar të drejtat pronësore mbi këtë bazë, duhet të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative, përkatësisht: (i) kushti i parë është që personi i cili ndërton mund të jetë bartës i të drejtës pronësore e që në rastin konkret, sipas dispozitave në fuqi, kusht të cilin e pranon edhe paditësi, ai nuk ka mundur të konkurrojë sepse e kishte një banesë në shfrytëzim; (ii) kushti i dytë është që ai i cili ndërton nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë se është duke ndërtuar në tokën e dikujt tjetër, është e qartë se ky kusht nuk është plotësuar, pasi që paditësi ishte i vetëdijshëm se parcela mbi të cilin ai e vazhdoi ndërtimin ishte e dikujt tjetër, pavarësisht pretendimit se ai kishte një

marrëveshje me të ndjerin M.K., përderisa e njëjta nuk ishte me shkrim siç parashihet me ligj, ajo nuk prodhon efekt juridik, andaj në momentin e vdekjes së të ndjerit, të drejtat dhe detyrimet u kaluan trashëgimtarëve, dhe përderisa paditësi nuk e kishte pëlqimin e tyre, nuk mund të themi se ai ishte një ndërtues i përgjegjshëm; dhe (iii) kushti i tretë është që pronari i tokës e ka ditur për ndërtimin por nuk ka kundërshtuar menjëherë, gjithashtu edhe sipas deklaratave të të paditurve, të paditurit e kërkuan nga paditësi dokumentacionin e shtëpisë, por paditësi nuk ua dha atë, që do të thotë se ai nuk e kishte pëlqimin e të paditurve për ndërtimin e shtëpisë. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se nuk rezulton se procedurat para gjykatave të rregullta në tërësinë e tyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare.

54. Prandaj, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu edhe arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”*, duke rezultuar me *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e pretendimeve të *“shkalles së katërt”* dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të *“ligjshmërisë”* dhe nuk janë argumentuar në nivel të *“kushtetutshmërisë”*. Për pasoje, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
55. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim aplikimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17, me parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, të cituar me lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, me parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).

(ii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 21, 24 dhe 46 të Kushtetutës

56. Sa i përket shkeljes së drejtave të garantuara me nenet 21, 24 dhe 46 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në bazë të kriterit (iii) pretendime *“të pambështetura ose te paarsyeshme”* kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, dhe atë;
 - a) Kur parashtruesi i kërkesës thjesht cek një apo më shumë dispozita të Konventës apo Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit kjo është krejtësisht e evidente (shih: në këtë kuptim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendimi)* nr. 4241/03 i 31 maj 2005,

shih, po ashtu, *Baillard kundër Francës (vendimi)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);

- b) kur parashtruesi i kërkesës dështon ose refuzon të sigurojë prova materiale për të mbështetur pretendimet e tij (kjo vlen veçanërisht për vendimet e gjykatave ose autoriteteve të tjera vendore), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të tij që e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, nëse organet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga dosja e lëndës së të burgosurit në fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, aktvendimi për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).
57. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm përmend shkeljet e neneve 21, 24 dhe 46 të Kushtetutës, por nuk shtjellon më tej në kërkesë se si dhe pse erdhi deri te shkelja e këtyre neneve.
58. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës KI175/20, të cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20, të cituar më lart, paragrafi 52, KI04/21 të cituar më lart, paragrafët 38-39).
59. Prandaj, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 21, 24 dhe 46 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se duhet të deklarohen si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “*të pambështetura ose të paarsyeshme*”, sepse parashtruesi i kërkesës vetëm thjesht ka përmendur një apo më shumë dispozita të Konventës apo Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për mos publikimin e identitetit

60. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet në publik, pa ofruar arsye konkrete për këtë.
61. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton rregullin 32 (6) të Rregullores së punës, i cili thotë se “*Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë...*”.
62. Sidoqoftë, Gjykata konstaton se në kërkesë, parashtruesi i kërkesës në lidhje me kërkesën e tij për mos zbulim të identitetit as nuk arsyeton e as nuk ofron apo parashtron ndonjë provë për të mbështetur kërkesën e tij për mos zbulim të identitetit.

63. Rrjedhimisht, Gjykata e hedh poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mos publikim të identitetit.

Përfundim

64. Rrjedhimisht, në bazë të asaj që është thënë më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe faktet e paraqitura prej tij, Gjykata, bazuar në standardet e përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e (i) nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm në rrethanat e rastit të tij, përbëjnë pretendime të *"shkallës së katërt"*; ndërsa (ii) pretendimet për shkelje të neneve 21, 24 dhe 46 të Kushtetutës përbëjnë pretendime *"të pambështetura ose të paarsyeshme"* dhe si të tilla, ato janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 3 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për mos publikim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani

